



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 7484 / prot. 1

Tiranë, më 01.12.2023

UDHËZIM

Nr. 24, datë 01.12.2023

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015 “PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të shkronjës “d” të pikës 8 të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, “Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit”, të ndryshuar të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

a) Shkronja “k” e pikës 4, shfuqizohet.

b) Në shtojcën nr. 1, pas profilit me numër rendor 24, të shtohen profilet me numër rendor 25 dhe 26 si më poshtë:

“25. *Arte skenike, kodi 25;*
26. *Koreografi, kodi 26.*”.

c) Shtojcat nr. 2 dhe nr. 3, të udhëzimit nr. 10, datë 3.4.2015, i ndryshuar, zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar, njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
OGERTA MANASTIRLIU



SHTOJCA NR 2

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. ID (Kartë identiteti/pasaportë)	ZVAP	Datëlindja	Vendlindja	Viti i diplomimit	Institucioni i Arsimit të Lartë	Fakulteti	Diploma bachelor	Diploma Master	Profili	Hera



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Qendra e Shërbimeve Arsimore

Licencë

PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË MËSUESIT NË PROFILIN _____

I lëshohet Z./Znj. _____ në zbatim të _____
(Emër, Atësi, Mbiemër) (Datelindja) (Vendlindja)

ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pas përfundimit të studimeve të ciklit të dytë Master _____ në _____, kryerjes me sukses të praktikës profesionale dhe kalimit në provimin e shtetit në datën _____.

Drejtori i Përgjithshëm

Data: XX.XX.XXXX

Numri i licencës: XXXXXXXXXXXXX